

EPPC Albania kërkon një **Laborant/e** për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha dhe të konsoliduara në vend në prodhim.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Përgatit teste (prova/samples) që duhen për të bërë analizat;
- Kryen testimet e produkteve në të tre fazat: lëndë e parë, produkt gjatë prodhimit dhe produkt i gatshëm, duke zbatuar të gjitha procedurat e shkruara të laboratorit për çdo proces;
- Kryen kontrolle ditore të cilësisë së produkteve, si dhe përgatit raporte me të dhena të vlefshme dhe të sakta;
- Përditëson dijet e tij/saj për industrinë ku punon dhe përdor metodologjitë dhe praktikat më të fundit për analizat që kryen;
- Kryen analiza fiziko-kimike dhe baktoreologjike të produkteve;
- Mirëmban pastërtinë, rregullin dhe furnizimet me lëndë të para për laboratorin dhe pasjisjet e laboratorit në mënyrë që të mos dëmtohen dhe të jenë gjithmonë gati për të kryer testin e radhës;
- Regjistron rezultatin e çdo analize dhe plotëson dokumentacionin përkatës për secilën nga ato;
- Ndihmon me detyra administrative kur është nevoja.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- **Diplomë Universitare** në degët **Kimi/Biologji** apo profile të ngjashme;
- Eksperienca e mëparshme përbën avantazh;
- Preferohet të jetë **banuese në Lushnjë ose zonat perreth**;
- Të ketë njohuri të mira të kompjuterit;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe e aftë të punojë në grup.

Të dhënat:

Pozicioni:	Laborant/e;
Vendndodhja:	Lushnjë;
Raporton tek:	Menaxheri i fabrikës;
Pagesa:	Shumë e mirë
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	21.09.2018.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.